



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: DVP Elbasan/Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 4 shtetas dhe vijon puna për kapjen e 1 tjetri, për vepra të ndryshme penale

Durrës/Vihen në pranga 3 autorë të dyshuar veprash të ndryshme penale

DVP Shkodër/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 4 të tjerë, autorë të dyshuar për vepra të ndryshme penale

DVP Vlorë/Procedohen penalisht 3 shtetas dhe punohet për kapjen e 1 tjetri, autorë të dyshuar për vepra të ndryshme penale

Kukës – Procedohet pebalisht 1 shtetas, për veprën penale “Plagosja e rëndë nga pakujdesia”



10/01/2024

Mat – Lëvizte Në Rrugët E Fshatit Me Armë Gjahu Duke Krijuar Panik Tek Banorët, Falë Bashkëpunimit Me Qytetarët, Lokalizohet, Kapet Dhe Procedohet Penalisht Autori

Mat

Lëvizte në rrugët e fshatit me armë gjahu duke krijuar panik tek banorët, falë bashkëpunimit me qytetarët, lokalizohet, kapet dhe procedohet penalisht autori.

Poseduesi i armës një 17- vjeçar, për të cilin nisi hetimi penal në gjendje të lirë për shkak të moshës.

Sekuestrohet arma e gjahut dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, si dhe në zbatim të detyrave të përcaktuara në planin e masave në kuadër të operacionit mbarëkombëtar të koduar “Sundimi i Ligjit”, falë informacioneve të siguruara nga bashkëpunimi me qytetarët, për një shtetas të mitur, i cili lëvizte në rrugët e fshatit Stojan, me një send në duar në dukje si armë gjahu duke shkaktuar panik tek banorët, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Stojani”, për kapjen e tij.

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë bërë të mundur rrethimin e zonës ku lëvizte 17-vjeçari, dhe në kohën e ndërhyrjes së Policisë, 17-vjeçari ka tentuar ta fshehë armën e gjahut në tavanin e banesës së shokut të tij.

Në përfundim të veprimeve të para herimore, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Mat, nisën procedimin penal në gjendje të lirë, për shkak të moshës për shtetasin O.C., 17 vjeç, banues në fshatin Stojan, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Arma e gjahut dhe municioni luftarak, , u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë👮🚓

tëvendosurkundërkrimit✅

nëçdoskajtëvendit🚔

nëshërbimtëqytetarëve👮🤝👤

denonconë112📞✅



◀ Me rastin e 111-vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit, gjatë ditës së sotme, ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, u vizituan nga një grup nxënësish

DVP Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Cigarette” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)